



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2185 prot

Roskovec, më 26.03.2024

VENDIM

NR 23 . DATË 25.03 .2024

**“PËR MIRATIMIN E BASHKËFINANCIMIT, PËR PROGRAMET E STREHIMIT
SOCIAL”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; të shkresës Nr.741 prot. datë 12.01.2024 “Mbi Fondet për programet e strehimit 2024” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Udhëzimit Nr.31, datë 18.11.2019, “Për Procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit” referuar Ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" të ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 109, datë 21.12.2023 “Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të bashkisë dhe ndërmarrjet vartëse për vitin 2024”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 07, datë 30.01.2024, “Për miratimin e listës së përfituesëve nga programi Përmirësimi i Kushteve të Banimit për Komunitete të Varfëra dhe të Pafavorizuara”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 13, datë 19.02.2024 “Për një shtesë dhe ndryshim në VKB Nr. 07 datë 31.01.2024 “Për Miratimin e Listës së Përfituesve nga Programi Përmirësimi i Kushteve të Banimit për Komunitete të Varfra dhe të Pafavorizuara”; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë bashkëfinancimin prej 50% për projektin si më poshtë:

- **“Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”**

Vlera e plotë e projektit është: **9 979 079 lekë me TVSH, nga e cila 50% financohet nga Bashkia.**

Bashkia Roskovec merr përsipër të financojë 50% të vlerës së plotë të projektit konkretisht 4 989 539.5 lekë me TVSH “ Përmirësim i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”.

2.Ngarkohen Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria Ekonomike me zbatimin e këtij vendimi.

3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Afrim Plaka

